



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, sipas shkresës së MAPL nr. 02-129/2, datë 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE OJQ-KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS NË FUSHËN E AKTIVITETEVE SPORTIVE

Neni 1

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike e OJQ-Klubeve sportive në Komunën e Podujevës, në fushën e aktiviteteve sportive ofrohet nga buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

Neni 2

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve./ klubeve sportive, pas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 - 2.3. Forma e deklaratimit të mungesës së fondeve të dyfishta
 - 2.4. Deklarata e Partneritetit

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-030/03-0052412/20
Podujevë, 01 shtator 2020

**Nënkryetari i Komunës**
Nexhmi Rudari




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, sipas shkresës së MAPL nr. 02-129/2, datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTE/PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE NË KOMUNËN E PODUJEVËS NË FUSHËN E AKTIVITETEVE KULTURORE DHE RINORE

Neni 1

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve në Komunën e Podujevës, në fushën e aktiviteteve kulturore dhe rinore si: festivaleve, aktiviteteve rinore, ekspozita dhe manifestime ofrohet nga buxheti i Komunës së Podujevës, kodë ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

Neni 2

Mjetet e financiare shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, pas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:

- 1.1. Teksti i thirrjes publike
- 1.2. Udhëzimet për aplikantët
- 1.3. Formularët e aplikimit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
- 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
- 2.3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta
- 2.4. Deklarata e Partneritetit

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1.Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2.Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3.Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-030/03-0052414/20
Podujevë, 01 shtator 2020

Nënkryetari i Komunës
Nexhmi Rudari





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, duke iu referuar Vendimit të Kuvendit të Komunës së Podujevës nr. prot. 01-511-52459, datë 29 qershor 2016 për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor – Spitalit të Përgjithshëm në Komunën e Podujevës, si dhe Vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë nr. prot. 01-05-7029, datë 27 tetor 2016, për themelimin e Spitalit të Përgjithshëm në Komunën e Podujevës,

Sipas shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

I.

Dr. Zaim Thaçi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Podujevës, emërohet koordinatori i Komunës së Podujevës me Ministrinë e Shëndetësisë - Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, që të koordinojë të gjitha punët dhe aktivitetet me qëllim të funksionalizimit të Spitalit të Përgjithshëm në Komunën e Podujevës.

II.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë
Drejtorit të SHSKUK-së
Të emëruarit (Koordinatorit)
Arkivit

Nr. 02-020/05-0053002/20
Podujevë, 03 shtator 2020

Nënkryetari i Komunës
Nexhmi Rudari





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18 dhe Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës nr. 01-352/11-0084561/19, në zbatim të Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës (2017-2022), sipas shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkrjetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ngritet Grupi punues për shpërndarjen dhe monitorimin e komposterëve në territorin e Komunës së Podujevës, në përbërje:

- | | |
|----------------------|----------|
| 1. Faik Muçiqi, | kryesues |
| 2. Rizah Muçolli | anëtar |
| 3. Shaban Beselica | anëtar |
| 4. Lirie Hyseni | anëtare |
| 5. Eset Abdullahu | anëtar |
| 6. Liridona Rrahmani | anëtare |
| 7. Doruntina Sollova | anëtare |
| 8. Masar Çitaku | anëtar |
| 9. Fidan Restelica | anëtar |
| 10. Fidan Salihu | anëtar |

Neni 2

Qëllimi i realizimi të projektit është që përmes komposterëve të zvogëlohet sasia e mbeturinave, si dhe të bëhet përpunimi dhe shndërrimi i tyre në pleh i cili do të përdoret për kultivimin e kopshteve.

Neni 3

Grupi punues përgatitë planin e punës, bën shpërndarjen e komposterëve dhe monitoron funksionimin e tyre, si dhe organizon fushatë për vetëdijesimin e qytetarëve.

Neni 4

Grupi për punën e tij informon Zyrën e Kryetarit në formë të shkruar.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të Grupit punues
Arkivit

Nr. 02-020/04-0053748/20
Podujevë, 07 shtator 2020

Nënkrjetari i Komunës
Nexhmi Rudari





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 74 paragrafi 3.3 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/l-114, nenin 18.2 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve publik dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkrjetari i Komunës, merr:

V E N D I M **PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE** **PËR NËPUNËSIT E SHËRBIMIT PUBLIK**

Neni 1

Themelohet Komisioni i ankesave për nëpunësit e shërbimit publik të Komunës së Podujevës, në përbërje:

1. Arianit Shaqiri, udhëheqës i sektorit të Gjendjes Civile, kryesues
2. Mirlinda Arifi, zyrtare ligjore, anëtare
3. Jehona Havolli, zyrtare e personelit, anëtare

Neni 2

Komisioni themelohet në mandat tre (3) vjeçar.

Neni 3

Funksioni dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publik nr. 06/l-114 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve publik.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Zyrës së Personelit
Arkivit

Nr. 02-020/04-0054507/20
Podujevë, 11 shtator 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në mbështetje të neneve 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 16 të statutit të komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Udhëzuesit të Përgjithshëm të MASH-it për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë covid 19, sipas Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me nr.prot.02-129/2 të datës 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, nxjerr;

V E N D I M

Neni 1

Themelohet Task Forca në Komunën e Podujevës për organizimin dhe mbikëqyrjen e procesit të mësimit në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë covid 19, në përbërje:

1. **Nexhmi Rudari**, Nënkyetar i Komunës, kryesues
2. **Agim Blakçori**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, anëtar
3. **Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, anëtar
4. **Zaim Thaçi**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, anëtar
5. **Florie Besholli**, inspektorati sanitar i Komunës, anëtare
6. **Bejtush Jashari**, u.d. Drejtor i QKMF, anëtar

Neni 2

Task Forca ndërmerr veprime dhe masat e nevojshme në përputhje me Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Udhëzuesin e MASH-it dhe rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë, përveç tjera:

- Përpilon planin e punës ku përfshihen mbledhjet e rregullta, orari, formati i takimeve, mënyra e vendimmarrjes.
 - Verifikon skenarët me nivelin e rrezikshmërisë në komunë dhe kushtet e shkollës përkatëse.
 - Monitoron zbatimin e skenarëve të vitit të ri shkollor, si dhe përcakton masat përkrahëse për shkollat.
 - Kordinon dhe menaxhon institucionet dhe personelin arsimor me përqendrim në realizimin e mësimit sipas skenarëve.
 - Vendos format e vendimmarrjes, raportimit dhe vlerësimit të performancës së personelit përmes komunikimit të kufizuar fizik dhe komunikimit nëpërmjet formave të aprovuara virtuale.
 - Cakton platformën digjitale që do të përdoret në nivel komune/shkollë, ku në nivel shkollë përdoret vetëm një platformë unike.
 - Organizon trajnimet për mësimsdhënësit në bashkëpunim me MASH dhe Donatorë;
 - Planifikon sigurimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore me kohë të nxënësit.
- Përkrahin edukatorët/mësimsdhënësit që kanë nevojë mbështetje për mësimin online dhe çështje tjera të parapara me Udhëzuesin e Përgjithshëm të MASH-it për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë covid 19.

Neni 3

Vendimi hyn ditën e nënshkrimit, dhe me të njëjtin njoftohen anëtarët dhe gjithë mekanizmat relevant të nivelit qendror dhe lokal.

Nr.02-020/03-0054994/20
Podujevë, 14 shtator 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, sipas Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale-SMPK të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, referuar Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me nr.prot.02-129/2 të datës 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, nxjerr;

V E N D I M

PËR EMRIMIN E KOORDINATORIT DHE ZYRTARËVE PËR ADMINISTRIMIN E SISTEMIT PËR MENAXHIMIN E PERFORMANCËS NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për administrimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës në Komunën e Podujevës, emërohen koordinatori dhe zyrtarët komunal, në përbërje:

1. Halit Vërshevc,	koordinator	(Kujdesi primar shëndetësor)
2. Bujar Gimolli,	anëtar	(Transparenca komunale)
3. Sabedin Namani	anëtar	(Shërbimet publike Administrative; Përgjegjshmëria komunale)
3. Arbëresha Bashota,	anëtare	(Barazia në punësim; Përfaqësimi gjinor)
4. Vedat Muçolli,	anëtar	(Kulturë, rini dhe sport)
5. Kujtim Zhitia	anëtar	(Menaxhimi i fatkeqësive)
6. Fatmir Latifi,	anëtar	(Planifikimi hapësinor)
7. Rizah Muçolli,	anëtar	(Hapësirat publike; Menaxhimi i mbeturinave; Mbrojtja e ambientit)
8. Doruntinë Sollova,	anëtare	(Infrastruktura rrugore)
9. Avni Syl,	anëtar	(Transporti publik; Parkingjet publike)
10. Naser Kajtazi,	anëtar	(Uji i pijshëm)
11. Granit Hasani,	anëtar	(Kanalizimi)
12. Ardian Emiri,	anëtar	(Arsimi parauniversitar)
13. Memli Gashi,	anëtar	(Zhvillimi ekonomik lokal)

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit dhe zyrtarëve janë të përcaktuara në dokumentin-Sistemi për Menaxhimin e Performancës komunale të MAPL.

Koordinatori dhe zyrtarët janë përgjegjës sipas fushave të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për emërimin e koordinatorit dhe zyrtarëve për administrimin e Sistemit për Menaxhimin e performancës në Komunën e Podujevës nr. 02-020/04-0003652/19, dt. 16 janar 2029.

Neni 4


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-020/04-0055357/20
Podujevë, 15 shtator 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 4 paragrafi 2.4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18,
Sipas shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Bekim Rudari, nga Podujeva, emërohet;

➤ **Shofer i Zyrës së Kryetarit të Komunës së Podujevës**

Neni 2

Mandati i të emëruarit është në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, përveç nëse me vendim të veçantë vendoset ndryshe.

I përmenduri emërohet me qëllim të ofrimit të mbështetjes teknike Kryetarit të Komunës gjatë ushtrimit të funksionit.

Neni 3

Paga mujore e të emëruarit caktohet në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa për zbatimin e tij kujdesen Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Personelit.

I dërgohet:
Të emëruarit
Drejtorisë së Administratës
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr. 02-112/02-0058089/20
Podujevë, 24 shtator 2020



Nënkyetari i Komunës
Nexhmi Rudari



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-50862, në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 01-020/04-0032340/20, datë 30 qershor 2020 dhe implementimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit për bashkëfinancim të ndërtimit të shtëpive familjeve në nevojë nr. 02-550/01-0031503/20, datë 27.06.2020, në mes Komunës së Podujevës dhe Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2, datë 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. **Arbresha Bashota**, zyrtare për strehim në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, caktohet zyrtare përgjegjëse në cilësinë e organit mbikëqyrës në përcjelljen e realizimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit për bashkëfinancim të ndërtimit të shtëpive familjeve në nevojë nr. 02-550/01-0031503/20, datë 27.06.2020, ndërmjet Komunës së Podujevës dhe Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit".

2. E përmendura për punën e kryer në formë të shkruar informon Zyrën e Kryetarit të Komunës.

Neni 2

1. Për pranimin e punëve të kryera sipas Marrëveshjes së cekur, gjatë procesit të ndërtimit të shtëpive, formohet Komisioni i përbashkët, në këtë përbërje:

- **Ardian Emini**, zyrtar në Drejtorinë e Arsimit
- **Ramush Jupolli**, zyrtar në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- **Bled Latifi**, përfaqësues i Shoqatës "Jetimat e Ballkanit"

2. Komisioni për punën e kryer në formë të shkruar informon Zyrën e Kryetarit të Komunës.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:
Të caktuarëve
Arkivës*

Nr. prot. 02-020/04-0058228/20
Podujevë, 25 shtator 2020

Nënkyetari i Komunës
Nexhmi Rudari





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 11, 13 dhe 58 shkronjat b), f) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03L-040, nenin 7 të Rregullores (QRK) nr.27/2018 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun, si dhe nenet 14, 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, në pajtim me Shkresën nr.prot.02-129/2 të datës 06.02.2020 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Nënkyetari i Komunës, nxjerrë këtë,

VENDIM PËR EMËRIMIN E ZËDHËNËSIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

z.Bujar Gimolli, bachelor i gazetarisë në fakultetin e Filologjisë – Universiteti i Prishtinës, emërohet Zëdhënës i Komunës së Podujevës, me mandat të njëjtë të Kryetarit të Komunës

Neni 2

Punët dhe detyrat kryesore të emëruarit sipas nenit 1 të këtij Vendimi, janë të përcaktuara me Rregulloren (QRK) nr.27/2018 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun, me theks nenit 7, si dhe dispozita tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 3

Paga mujore e të emëruarit përcaktohet sipas rregullativës ligjore në fuqi.

Neni 4

I emëruari, sipas ligjit në fuqi mban të drejtën e pezullimit sipas ligjit në fuqi, të vendit të punës në shërbimin civil në pozitën e deritanishme sipas akt emërimit përkatës dhe pas përfundimit të mandatit apo në rast se me ndonjë vendim tjetër përcaktohet ndryshe, i emëruari mban të drejtën e kthimit në punë në pozitën që e ka mbajtur para emërimit Zëdhënës i Komunës.


Neni 5

Vendimi hyn në fuqi nga data 28 shtator 2020, ndërsa për zbatimin kujdesen Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Personelit.

U dërgohet;
Të emëruarit
Zyrës së personelit
Arkivit të Komunës

Nr.prot.02-112/02-0058086/20
Podujevë, 24 shtator 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 14.2 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore 2021-2022 nr.01-400/03-0075925/19, dt. 23.09.2019, sipas konkursit të Drejtorisë së Arsimit nr. 05-56, dt. 12.02.2020, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, në pajtim me shkresën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL nr.prot.02-129/2 të datës 06.02.2020, Nënkryetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR NDARJEN E BURSIVE

Neni 1

1. Dyqind e dy (202) studentëve të Komunës së Podujevës, të cilët vijojnë studimet në fakultet e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, u ndahet bursë në shumë prej 450 € (shuma e përgjithshme 90,900 €), për vitin akademik 2019-2020.

2. Dyqind e njëzet e dy (222) nxënësve të Shkollave të Mesme të Komunës së Podujevës, u ndahet bursë, në shumë prej 250 € (shuma e përgjithshme 55,500 €), për vitin mësimor 2019-2020.

Neni 2

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 3

Pagesa e mjeteve sipas nenit 1 të këtij Vendimi bëhet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit.

Neni 4

Pjesë përbërëse e Vendimit është Lista e përfituesve të bursave.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.

Nr.02-610/07-00-59176/20
Podujevë, 30 shtator 2020

